



VENDIM

Nr. 49 Datë 24.05.2011

**PËR
FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR RISHIKIMIN E RREGULLORES
PER KRITERET E DHENIES DHE HEQJES SE STATUSIT TE
KLIENTIT TE KUALIFIKUAR**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 48, të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 121 dhe 128, të Ligjit nr.8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative“, nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.03.2009, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Bordi i Komisionereve të ERE-s, (E.R.E) në mbledhjen e tij të datës 24.05.2011, mbasi shqyrtoi draftin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike të saj dhe relacionin përkatës, për fillimin e procedurave për rishikimin e Rregullores për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të Klientit të Kualifikuar,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurave për rishikimin e Rregullores për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të Klientit të Kualifikuar

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.